VENDIM
Nr.1, datë 11.2.2011

PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin nga fondi prej 5 678 924 000 (pesë miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e njëzet e katër mijë) lekësh, pjesë e fondit të përgjithshëm për vitin 2011 për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, për projektet, sipas institucioneve në shumat e mëposhtme, përkatësisht për:

- Infrastrukturën rrugore, në vlerën prej 1 454 224 452 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë e katër milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekësh, e specifikuar për t'u përdorur për:

a) Likuidimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, me vlerë prej 1 378 175 572 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, sipas listës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Financimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, sipas ecurisë së punimeve fizike, në vlerën prej 76 048 880 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyzet e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh, sipas listës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, në vlerën 403 210 104 (katërqind e tre milionë e dyqind e dhjetë mijë e njëqind e katër) lekësh, sipas listës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vlerën 370 000 000 treqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, sipas listës nr.4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në vlerën 24 616 027 (njëzet e katër milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekë, sipas listës nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në vlerën 258 843 199 (dyqind e pesëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, sipas listës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë veprimet për bërjen efektive të fondeve.

KRYETARI
Sali Berisha

Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Anëtar
Ministri i Punëve Publike dhe Transportit	Anëtar
Ministri i Brendshëm	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Shkencës	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Anëtar
Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Anëtar
Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Kryetari i Bordit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar

Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Konferencës së Rektorëve	Anëtar